



-PUBLIKIMET SHKENCORE - STANDARTET E SHKRIMIT DHE BOTIMIT

Prof. As. Dhurata Bozo

Instituti i Kërkimeve për Sportin

2 Mars 2011

Kërkimi dhe botimet shkencore: të përgjithshme

2

- Shkenca është proces i perftimit të njohurive në mënyrë të organizuar dhe sistematike, që arrihet përmes grumbullimit të të dhënave, fakteve , hulumtimit, vëzhgimit dhe eksperimentimit, të cilat provohen dhe vërtetohen në mënyrë tërësore dhe të padyshimtë
- Zbulimet dhe shpikjet u bëhen të ditur të tjerëve përmes botimeve e publikimeve shkencore në forma e editorialë të ndryshëm.
- Një botim/publikim shkencor nuk mund të konsiderohet si i tillë nëse në themel të tij nuk ka kërkimin me elementët e mësipërm.
- Suksesi i një botimi nuk qendron vetëm në atë cka përmban dhe paraqet, por duhet të plotësojë edhe kërkesa e udhëzime “të të shkruarit cilësor” si dhe duhet të botohet në kohën e duhur dhe në periodikun, revistën, editorialin e duhur. Ato duhet gjithashtu ti nënshtrohen vlerësimit nga palë jo të interesuara dhe të botohen në revistat të klasifikuara si parësore për publikimet shkencore.
- Përmbajtja e një publikimi shkencor duhet të ketë informacionin e duhur në sasi dhe cilësi që të mundësojë:
 - Vlerësimin dhe verifikimin e gjetjeve/vëzhgimeve
 - Përsëritjen e eksperimentit
 - Vlerësimin e procesit intelektual që ka çuar në rezultatet
 - Të përmbajë të dhëna/zbulime/gjetje/shpikje origjinale
 - Të mbetet e të jetë lehtësisht e aksesueshme për komunitetin shkencor për verifikimin dhe përdorimin e vazhdueshëm të të dhënave/të rejave që sjell

Botimet shkencore; të veçanta

3 Standartet që duhet të plotësojë një botim që të konsiderohet i mirë:

I shkruar mirë

- (a) **Gjuha e qartë** dhe koncize, gramatika dhe fjalët korrekte,
- (b) Plotëson të gjitha **standartet e formës** të kërkuara nga botuesi; të ndryshme rast pas rasti por edhe sisteme/formate të standartizuara

Faktet që sillen janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme:

- (a) **Referencat dhe burimet** e të dhënave janë të qarta, lehtësisht të gjetshme dhe që lidhen me argumentat që trajtohen
- (b) Citimet bëhen nga **burime të besueshme** të kuotuar, statistika, opinione publike me vizione dhe argumenta të ndryshme, që në referencat personale i referohen personave që janë ende gjallë dhe që gjithashtu plotësojnë standartet specifike të botuesit
- (c) Përmban **kërkim dhe rezultate origjinale**

I gjerë në fushën që mbulon:

- (a) Adreson **aspektet kryesore të fushës** kërkimore
- (b) Qendron i **fokusuar në çështjen kryesore**, pa rënë në detajime të panevojshme që nuk lidhen me çështjen kryesore që hulumtohet

Neutral; duhet të përfaqësojë **pikpamje neutrale**, objektive pa treguar qendrim ndaj një ose një tjetre teorie.

I qendrueshëm: nuk duhet të ndryshojë nga dita në ditë për shkaqe të jashtme apo sipas kërkesave të vecanta/simpative të botuesit apo palëve të tjera të interesuara

Ilustrohet me figura, tabela foto, etj., të cilat kanë lidhje me argumentat, që respektojnë të drejtën e autorit dhe plotësojnë standartet e kërkesat specifike të botuesit.

*“ Të shkruash është lehtë. Mjafton të ulesh mbi një fletë të bardhë dhe ta kqyrësh derisa të shfaqen pika gjaku në ballë” --
- Gene Fowler shek.XIX*

4

- Aftësitë e komunikimit shkrimor dhe gojor janë cilësitë universale më të nevojshme për këdo por sidomos për komunitetin akademik e shkencor.
- Këto aftësi, të kombinuara me ato të transmetimit të dijeve dhe të vetë këtyre aftësive, duhet të përbëjnë boshtin e formimit të një mësuesi, pedagogu, kërkuesi e shkencëtari

Struktura e përgjithshme e një botimi shkencor

5

- Organizimi dhe struktura e një botimi shërben **për të lehtësuar leximin**, për të kuptuar **mesazhin kryesor** që ajo jep, për të dalluar **risinë, progresin apo metodën** që ajo sjell në morinë e informacionit, zbulimeve e të dhënave që ekzistojnë në atë fushë.
- Çdo ent botues harton **standarte të paraqitjes dhe përmbajtjes** që janë specifike por që në tërësi ndjekin një skemë të përgjithshme e ku përgjithsisht takohen shumë prej tyre
- Megjithatë në çdo rast, autori duhet të ndjekë rigorozisht kërkesat dhe standartet që cdo botues paraqet si kusht për pranimin e një punimi
- Standartet e botimeve lidhen me fushën e kërkimit, por kanë **ngjashmëri sidomos në organizimin e përgjithshëm dhe ato çka trajtohen në pjesët përbërëse.**

Organizimi i përgjithshëm

6

Çdo punim shkencor duhet të organizohet e të përbëhet nga seksionet e mëposhtme:

- (1) Abstrakti
- (2) Hyrja
- (3) Materialet dhe Metodat
- (4) Rezultatet
- (5) Diskutimi
- (6) Përfundimet, dhe
- (7) Literatura

Eshtë e rëndësishme të kuptohen ndryshimet midis seksioneve dhe se çfarë duhet përfshirë brenda secilit e në vendin e duhur.

Leximi kritik i artikujve cilësorë ndihmon gjithashtu aftësimin në shkrimet shkencore. Modelet e mira të fushës shkencore përkatëse, janë udhëzuesit më të mirë në planin praktik por duke mënjanuar plagjaturën

Titulli

7

- Titulli duhet të zgjidhet i tillë që të jetë **sa më informues** për artikullin/tezën.
- Titulli duhet të jetë **eksplicit dhe të tregojë qartë objektin/fushën e përgjithshme dhe specifike të studimit e punimit**
- Në titull përfshihen emrat dhe adresat e të gjithë autorëve dhe data e paraqitjes në entin botues.

Abstrakti

8

Qëllimi

Abstrakti është një përmbledhje e shkurtër dhe koncize në formën e një paragrafi të vetëm i një studimi të përfunduar ose që është në proces.

Presupozohet që përmes abstraktit, lexuesi në më pak se 1 min të mësojë mbi **kontekstin e studimit**, **qasjen** e përgjithshme të çështjeve, **rezultatet** e përftuara dhe **përfundimet** më të rëndësishme ose çështjet e tjera që dalin.

Si duhet të jetë abstrakti

1. Abstrakti shkruhet **pasi përfundohet pjesa tjetër e punimit**, përsa kohë është një përmbledhje e tij.
2. Kursimi i fjalëve është i rëndësishëm në shkrimin e abstraktit por jo në dëm të qartësisë dhe kuptimit. është e rëndësishme të përdoren **fjalë dhe fjali koncize, jopërshkruese por domethënëse.**

Abstrakti

Si përmbledhje e punimit, abstrakti duhet të përmbajë elementët e mëposhtëm:

9

- **Qëllimin e studimit** – hipotezat, çështjen kryesore dhe objektivat
- **Objektin, sistemin dhe metodën e studimit** duke treguar se pse janë përzgjedhur pikërisht ato
- **Rezultatet** përfshirë këtu të dhënat, cilado qofshin të llojit cilësor, sasiar po statistikor
- **Përfundimet kryesore** dhe çështjet që dalin për vijimin e mëtejshëm të studimit

Stili: në një paragraf të vetëm dhe konciz

Duke qenë përmbledhje e një pune të përfunduar, shkruhet **në kohën e shkuar**

Abstrakti qendron **më vete si strukturë** dhe **nuk i referohet** asnjë pjese tjetër të punimit të detajuar

Fokuset në **përmbledhjen e rezultateve**, ndërsa konteksti teorik e kërkimor përmbledhet një jo më shumë se 1 fjali dhe vetëm nëse e është e domosdoshme

Teksti i abstraktit dhe përmbajtja duhet të jenë **në koherencë** të plotë me cka zhvillohet në materialin e detajuar

Gjuha korrekte, qartësia e fjalive dhe shprehjeve si dhe paraqitja e të dhënave në vlera të sakta dhe në njësitë e duhura, janë po aq të rëndësishme

Hyrja

10

Qëllimi:

Qëllimi i hyrjes është t'i bëjë të njohur lexuesit **kontekstin teorik dhe kërkimor** në të cilin kryhet studimi, **qëllimin** e kryerjes si dhe t'i japë mundësinë të kuptojë e **të vlerësojë qëllimin, synimet e rëndësinë** e tij

Si duhet të jetë hyrja

- Hyrja duhet të përshkruajë **rëndësinë dhe domethënien e studimit**; pse kryhet, pse ka rëndësi duke e vendosur në kontekstin e gjerë teorik e kërkimor
- Të tregojë **objektin e kërkimit, arsyen e zgjedhjes së tij dhe metodave hulumtuese, përparësitë që paraqesin si nga pikapamja zhvillimore teorike ashtu dhe arsyet practice të përzgjedhjes së tyre**
- Të përshkruajë **llogjikën dhe arsyet e kërkimit** përmes ngritjes së hipotezave specifike dhe synimeve të mirëpërcaktuara si dhe të shpjegojë e arguemntojë arsyen e përzgjedhjes së tyre

Hyrja

11

□ Stili

- Përdor **kohën e shkuar** me përjashtim të rasteve kur sillen të dhëna, faktike absolute e të mirëvërtetuara(kur ajo çohet për botim është një punë e përfunduar)
- Organizimi dhe strukturimi i ideve dhe përmbajtjes bëhet në mënyrë të tillë që **çdo paragraf të trajtojë një aspekt të veçantë**. Mendimi duhet të mos jetë i fragmentuar dhe evitohet krijimi i paragrafëve artificialë që lenë vend për keqkuptim.
- Konteksti teorik duhet të sillet **në masën dhe formën që i shërben** paraqitjes së punimit konkret. Teprimi me informacion të panevojshëm ul vëmëndjen e lexuesit duke patur parasysh që është dhe seksioni i parë i punimit.
- **Hipotezat dhe objektivat** duhet të parashtrohen qartë dhe në masën e duhur; por **pa i thjeshtuar më shumë se ç'duhet**. Ato japin pamjen e parë të asaj që shtjellohet më pas.
- Gjuhë korrekte, qartësi e fjalive dhe shprehjeve

Materiali dhe Metodat

Materiali dhe metodat mund të paraqiten si seksione të veçanta sikurse mund të paraqiten dhe në formë të integruar

12

Qëllimi

- Qëllimi i këtij seksioni është të dokumentojë materialin e përdorur, të përgjithshëm dhe specifik, procedurat dhe metodat e përdorura.
- Kjo bën të mundur që të tjerët të mund të përdorin këto të dhëna në punën e tyre si dhe të vlerësojnë meritën shkencore të punimit. Nuk duhet të jetë ezaurient dhe tepër i hollësishëm pasi **nuk është një manual apo udhëzues laboratorik.**

Si duhet të jetë seksioni Materiali dhe Metodat

Materialët:

- Ky nënseksion ndahet më vete vetëm në rast se studimi është i komplikuar dhe vetë materialet përmbajnë risi
- Përfshihen të gjitha **mjetet dhe pajisjet specifike të përdorura** të cilat nuk gjenden rëndom në laboratorët po që përdoren nga të gjithë; përjashtim bëjnë mjete apo pajisje të vecnata, të reja apo unike që nuk njihen ose njihen pak
- Në bioshkenca, ku përdoren gjerësisht solucione të gatshme apo të përgatitura on site, përshkrimi tyre duhet të jetë në detaje

Materiali dhe Metodat

Si duhet të jetë seksioni Materiali dhe Metodat

13

Metodat

- Paraqitet **metodologjia e përdorur në cdo procedurë**, me përjashtim të rasteve kur përdoren të njëjtat metoda
- **Metodat përshkruhen në detaje** duke i ndarë dhe në nënseksione sipas natyrës së tyre apo në grupmetoda
- Metodat duhet të trajtohen **të përgjithësuara**; si kryhen zakonisht jo në raste apo ditë specifike. Duhet patur parasysh se dikush tjetër që tregon interes mund të provojë të përdorë të njëjtën metodë që duhet të jetë funksionale
- Në rastet kur përdoren procedura dhe metoda të mirënjohura e të përdorshme nga të gjithë, mjafton citimi i saj dhe autori referues. Në këtë rast nuk ka nevojë që ajo të shoqërohet me detaje
- **Stili:**
 - Përsa kohë paraqet punën konkrete të kryer nga autori, ky seksion mund të shkruhet në vetën e parë njëjës ose shumës. Kjo mënyrë fokuson vëmendjen më shumë tek autori se sa tek procedura, ndaj shpesh përdoret **veta e tretë pasive** për këtë seksion.
- **Çfarë duhet konsideruar - evituar:**
 - Materialet dhe metodat nuk janë udhëzues përdorimi. Ato shërbejnë **për të personalizuar punën e kryer dhe janë në shërbim të rezultateve të përftuara**
 - Duhet shmangur shpjegimet, komentet dhe rezultatet e marra
 - Nuk duhen dhënë shpjegime të panevojshme dhe që nuk lidhen direkt më punimin konkret

Rezultatet

Qëllimi

Qëllimi i rezultateve është të paraqesë dhe ilustrojë **gjetjet, zbulimet origjinale te kërkimit**. Ai duhet të përmbajë raportimin objektiv të të gjitha rezultateve, duke lënë komentimin dhe diskutimin e tyre për seksionin vijues, diskutimin.

14

Si duhet të jetë seksioni Rezultatet

□ Përmbajtja

- Gjetjet përmbliidhen **në formë teksti** dhe shoqërohen me figurat dhe tabelat e posaçme.
- Në tekst përshkruhet **çdo rezultat i marrë**, duke e drejtuar vëmendjen e lexuesit tek ato që janë më domethënëse e që lidhen direkt me qëllimin e studimit.
- Përshkruhen edhe rezultatet që janë marrë nga metodat apo eksperimentet që nuk shoqërohen me ilustrime.
- Fillimisht analizohen të dhënat , më pas ato kthehen në formë figure apo tabele.

□ Çfarë duhet shmangur

- Nuk duhen bërë diskutime, të mos interpretohen rezultatet dhe as të shpjegohen e argumentohen në këtë seksion
- Nuk duhen përfshirë të dhëna bruto, të procesit apo të papërpunuara; nuk duhen paraqitur llogaritjet e ndërmjetme
- Nuk duhen paraqitur dy herë të njëjtat të dhëna, as në forma të ndryshme
- Teksti duhet të përplotësojë figurat dhe tabelat, nuk duhet të shpegojë ato dhe as të përsëritë të njëjtin informacion
- Nuk duhen ngatërruar figurat me tabelat; janë të ndryshme nga njëra tjetra

Rezultatet

Stili

15

- Përdoret gjithmonë **koha e shkuar** dhe gjithshka vendoset në rend llogjik
- Figurat dhe tabelat duhet të **numërohen në mënyrë të pavarur** nga njëra tjetra; po kështu duhet ti referohet dhe teksti
- Figurat dhe tabelat mund të vendosen përgjatë tekstit ose në fund të seksionit. E rëndësishme është që të kenë **numra dhe referencat në tekst**.

Figurat dhe Tabelat

- Pavarësisht vendvendosjes së tyre, **figurat** duhet të **numërohen në mënyrë konsektive dhe të shoqërohen me diçiturën përkatëse**, e cila vendoset në pjesën e poshtme të secilës
- Pavarësisht vendvendosjes së tyre, **tabelat** duhet të **numërohen në mënyrë konsektive dhe të shoqërohen me numrin që vendoset në pjesën e sipërmë dhe titullin e përshkrimit që vendoset në pjesën e poshtme**
- Çdo figurë dhe tabelë duhet të ketë përmasa të tilla që të **qendrojë e veçuar dhe në faqe të veçanta e ndarë nga teksti**

E rëndësishme fillimisht është të ndahet qartë çfarë duhet të përfshihet në këtë seksion nga rezultatet e marra, duke i dalluar nga ato që janë të dhëna bruto apo të ndërmjetme që nuk duhet të publikohen, me përjashtim të rasteve kur kërkohen nga botuesi

Diskutimi (1)

Qëllimi

16

Qëllimi i këtij seksioni është të paraqesë **interpretimin e rezultateve dhe bazën e përfundimeve që nxirren nga studimi**, mbështetur në njohuritë e përfuara dhe rezultatet e marra nga studimi. Këtu duhen paraqitur qartë **domethënia e gjithshkaje të përftuar**.

Si duhet të jetë Diskutimi

- Interpretimi i të dhënave duhet të bëhet **në thellësinë e duhur sipas rëndësisë dhe domethënies që kanë vetë rezultatet**. Kur shpjegohet një dukuri, duhet përshkruar **mekanizmi/at që qendrojnë në bazë të saj**.
- Kur rezultate ndryshojnë nga ato të pritura duhet shpjeguar pse kjo ka ndodhur apo duhet të ketë ndodhur. Nëse rezultatet përputhen me ato të pritura, duhet shpjeguar e sjellë argumentat që rezultatet vërtetojnë apo shpjegojnë. **Nuk mjafton të tregohen rezultatet, por të shpjegohen ato, si në rastin kur përputhen ashtu dhe nuk përputhen me ato të pritura**.
- Duhet paraqitur **edhe rezultatet që bien ndesh me hipotezat e hedhura**; në këto raste duhen kërkuar apo supozuar shkaqet dhe/apo arsyt që qendrojnë në bazë të këtyre gjetjeve; **nuk duhen eliminuar e shmangur rezultatet që nuk përputhen me pritjet**"
- Puna e kryer duhet të ketë **një përfundim të plotë** ose të vetë studimit.
- Mund të sugjerohen **drejtime të reja kërkimi apo plotësimi të studimit**; psh shtrirja apo modifikimi për qëllim e objektiva të tjera.

Diskutimi (2)

17

Si duhet të jetë Diskutimi

- Duhet shpjeguar të gjitha vëzhgimet e kryera duke u përqendruar tek **mekanizmat** që qendrojnë në bazë të tyre se sa në vetë rezultatet e vëzhgimeve.
- Duhet sjellë edhe **shpjegime alternative** nëse ekzistojnë të tilla apo qendrojnë. Çfarë fushash të reja kërkimore hap një studim i tillë? Ato parashtrihen duke patur parasysh kuadrin e gjerë të fushës dhe se ku mund të shkohet me një kërkim të dytë të mëtejshëm apo më të thelluar. Çfarë mbetet akoma?
- **Stili:**
 - ▣ Në referencat ndaj informacioneve apo të dhënave, duhen dalluar ato të sjella nga të tjerët nga të autorit dhe sillen në kohën e shkuar
 - ▣ Gabimi më i zakonshëm që bëhet për këtë seksion është se më shumë përsëriten rezultatet se sa interpretimi i tyre .

Literatura

18

- Ka standarte të shumëllojshme për mënyrën dhe formën në të cilën duhet të paraqitet literatura si në tekst ashtu dhe në seksionin e vecantë.
- Megjithatë, në këtë seksion duhet të citohen **të gjitha referencat** e përmendura apo të cituara në tekst.
- Listimi duhet të bëhet **në rend alfabetik** sipas emrit të autorëve (autorit të parë)
- Duhet cituar **vetëm ato që përbëjnë literaturë primare**, pra punime origjinale të autorëve origjinalë
- Burimet nga web konsiderohen jo të sigurta dhe të sakta
- Nëse citohen burime online duhen përshirë detyrimisht emri, volumi, viti dhe numri i faqeve.

Këshilla praktike

1. Njihni paraprakisht audiencën dhe shkruani posaçërisht për ta

20

- Shkrimi akademik, shkencor dhe teknik kurrë nuk bëhet për qëllim të përgjithshëm dhe për këdo; ai shkruhet **për një audiencë specifike**.
- Për çdo fushë, audienca përbëhet nga **komuniteti shkencor i fushës** apo njerëz që merren me praktikën në atë fushë, por që kanë të përbashkët atë që kanë interes të lexojnë një revistë apo periodik të fushës.
- Stili dhe niveli i të shkruarit **përshtatet pikërisht me këtë lexues** dhe duhet të plotësojë pritjet që ai ka. Konvencionet stilistike dhe gjuha e terminologjia ndryshon në mënyrë të dukshme në varësi nga ky fakt.
- Një person që shkruan për herë të parë në një periodik, duhet së pari të **familjarizohet** me sa më sipër dhe të ndjekë me shumë kujdes dhe vëmendje “Udhëzimet për autorët” si dhe të lexojë artikuj në periodikë të fushës së tij por edhe të fushave të tjera.

2. Përgatitni një skicë-punim (outline) për të organizuar paraprakisht strukturën dhe përmbajtjen e shkrimit

21

- Fillimisht përgatitet një **projekt-ide me aspektet kryesore** që do të trajtohen. Më pas pasurohet çdo bllok kryesor me atë çka do shkruhet në çdo bllok. Gjithshka renditet **në mënyrë logjike** që në fillim, pa nisur shkrimi. Përndryshe punimi mbetet pa bosht, jointegral dhe i paorganizuar.
- Ndani qartë:
 - (1) **Çfarë** doni të thoni
 - (2) Planifiko **renditjen dhe logjikën e argumentave** që sillni
 - (3) Përpunoni **gjuhën e saktë** në të cilën do shprehni sa më sipër
- Pasi përcaktohet gjithë sa më sipër, **çdo kapitull fillon shtjellohet** duke ndjekur nëntemat në të cilat është ndarë që në koncept-idenë e përgjithshme.
- Gjatë shkrimit lindin dhe ide të tjera mbi shkrimin e asaj pjese apo pjesëve të tjera; menëherë ato hidhen në draftin-outline; **çdo proces ndihmon e pasuron tjetrin paralelisht** .

3. Ndaje projektin e madh në miniprojekte dhe puno me secilin veçmas

22

- Një tezë apo artikull nuk shkruhet si i tërë por **në pjesë**. Mendoje një artikull në pjesët e tij jo në bllok kur fillon të shkruash.
- **Pjesët** e një shkrimi përgatiten **veç e veç në seksione individuale**; ndërkohë organizimi i ideve, mendimeve dhe strukturës bëhen në fazën e parë të planifikimit.
- Nuk është e thënë që kur fillon të shkruash të kesh gjithshka të qartë në kokë se do shkruash; vetë **procesi të sjell ide, mendime të reja dhe pasuron mendimet e idetë fillestare**.
- **Shkrimi paralel dhe feed backu shumëlateral** ndihmon integritetin dhe ndërlidhjet midis pjesëve.

4. Mendo paraprakisht për strukturën e paragrafëve.

- Strukturimi i përmbajtjes është problemi kryesor që dëmton cilësinë e shkrimit.

23

- Nuk ka rëndësi vetëm cka shkruhet, sa e saktë apo e strukturuar është, por dhe **vendi dhe si integrohen ato në paragrafë që kanë lidhje logjike apo përmbajtësore me njëri tjetrin.**
- çdo paragraf **fillon me një fjali që fokuson çështjen që ai trajton**; çka vijon detajon pikërisht këtë çështje. Fjalitë kyçe duhet të jetë e qartë, koncize dhe e drejtpërdrejtë. Fjalitë e mëtejshme renditen në vijë logjike
- Normalisht **fjalitë mbyllëse e një paragrafi duhet të përbëjë një urë lidhëse me paragrafin që vijon.** Kjo siguron vazhdimësinë e mendimit dhe ndërlidhjen midis paragrafëve që e bën çdo bllok të shkrimit unik, integral dhe të lidhur si në përmbajtje ashtu dhe logjikë. Mbyllja e paragrafit nuk bëhet në mënyrë apo **me fjalë absolutiste apo në formë të klonkluzioneve** pa ide, hipoteza apo rrugëdalje të mëtejshme.
- Kur listoni disa ide në një renditje të catuat, trajtimi i mëtejshëm i detajuar i tyre duhet të ndjekë të njëjtën renditje. Renditja ndjek logjikën rrjedhëse të të dhënave, zbulimit apo trajtimit të argumentit.
- Në strukturë dhe përmbajtje të paragrafëve duhet patur parasysh se si i paraqitet ai një lexuesi, sa e lehtë është të kuptohet pasi presupozohet që lexuesi specialist nuk duhet ta lexojë disa herë për ta.
- Paragrafet **s' duhet të jenë tepër të shkurtër** (1-2 fjali) pasi është e pamundur të shtjellojnë dicka me këtë volum. Outline ndihmon edhe për të përcaktuar bashkimin apo ndarjen e paragrafëve sipas ideve-të dhënave që shtjellojnë.
- **Fragmentarizimi** është një problem tjetër që rrjedh nga përdorimi i kompjuterit materiali mund të rezultojë totalisht i palidhur nëse nuk rieditohet.

5. Mos përdorni shumë fjalë aty ku mund ta përshkruani me më pak

24

- Jo fjalë apo fjali të gjata aty ku mund të përdoret **gjuhë më sintetike**.
- Shkrimi sintetik është shkrimi i shkencës.
- Jo fjalë “zhargoni”/popullore kur kjo mund të arrihet me anë të **gjuhës teknike**.
- Në të kundërtën, **jo e ngarkuar me terma tepër teknikë** kur mendimi i shprehur është i tillë që mund të shprehet me terminologji më të përgjithshme; kjo zgjeron audiencën

6. Trego dhe fakto, mos përshkruaj

- Në vend që të tregohet se sa i rëndësishëm apo domethënës është një zbulim, **duhet treguar e dëshmuar vetë zbulimi.**
- Renditja e fakteve dhe zbulimeve është kryefjala e çdo artikulli kërkimor; për të treguar **rëndësinë, vlerën e domethënien shërbejnë diskutimi dhe konkluzionet;**
- Rezultati dhe vlera e punës së autorit duhet të **dëshmohet përmes fakteve e rezultateve jo komenteve mbi verën që ato kanë.** Ky është objekt i oponencave e recensave profesionale që artikulli i nënshtrohet.

7. Shkruaj për rezultatet, jo për tabelat, figurat, statistikat?

26

- Rezultatet janë seksioni qendror ku paraqitet puna origjinale e autorit.
- Rezultatet përbëhen kryesisht nga teksti, jo nga figurat dhe tabelat.
- Figurat dhe ilustrimet shërbejnë për të ndihmuar kuptimin e rezultateve por nuk janë objekt më vete. Ato veçse shoqërojnë tekstin, dëshmojnë dhe ndimojnë të kuptuarit dhe vërtetësinë e rezultateve ndjekin vijën përshkrimore të tekstit të rezultateve, por jo anasjelltas.
- Nuk duhet tepruar me ilustrime në mënyrë të panevojshme.
- Të njëjtat të dhëna nuk duhen paraqitur me tabela dhe grafikë njëkohësisht. Megjithatë fillimisht duhen përgatitur sa më shumë tabela e figura; ato renditen sipas vijës llogjike të prezantimit. Në vijim ndërtohet dhe shtjellohet teksti i rezultateve sipas renditjes së ilustrimeve.
- Figurat shpjegohen përmes diçiturave; nuk ka nevojë që e njëjta gjë të shkruhet dhe në tekst dhe në diçiturat

8. Përqëndrohu tek hipotezat shkencore të fushës jo në ato statistikore

27

- Fokusi kryesor i rezultateve janë zbulimi, të rejat që rrjedhin nga kërkimi, jo statistikat që kryhen në shërbim të vetë kërkimit.
- Kërkimi dhe zbulimi ka faktet si rezultat, jo përpunimin e tyre.
- Të dhënat, përpunimet statistikore e matematikore janë mjete, instrumenta për zbulimi e hulumtim por nuk janë vetë kërkimi
- Hipotezat, rezultatet dhe konkluzionet që nxirren nga një zbulim duhet të përbëjnë vetë fushën e kërkimit por jo statistikat rreth tyre.
- Një hipotezë, përfundim statistikor, pa një domethënie kërkimore nuk ka asnjë vlerë dhe as mund të klasifikohet si kërkim

9. Kujdes me strukturën e fjalive

- Ka shumë rëndësi struktura e fjalive dhe koha e foljeve në një botim.
- Puna e kryer shkruhet gjithmonë me folje në kohën e shkuar pasi është një punë e përfunduar. Ajo çka shqyrtohet, **idetë dhe hipotezat që hidhen shkruhen në kohën e tashme**; ajo **çka mendohej** që ndoshta është hedhur poshtë, **në të shkuarën**.
- Shumë kujdes në përdorimin e ndajfoljeve **mundet, ndoshta, ka mundësi që, ka të ngjarë**; këto nuk tregojnë arritjen e një rezultati të qartë por përdoren për hipoteza që hidhen për vazhdimin e mëtejshëm apo për të tjerë që studjojnë dhe hulumtojnë në këtë fushë

10. Diçiturat e tabelave dhe figurave

- Diçiturat nuk duhet të emërtojnë thjesht një tabelë apo figurë, por të shpjegojnë ose ndihmojnë si të lexohet e kuptohet
- Duhet të përmbajë informacion të mjaftueshëm që të kuptohet lehtë, pa patur nevojë ti referohesh tekstit. Ndërkohë tabela apo figura të tjeshta mund dhe të mos kenë nevojë për detaje të tepërta
- Diçiturat janë efektive kur përmbledhin rezultatet apo të dhënat kryesore që paraqiten në ilustrimet. Këto shkruhen së bashku me figurën/tabelën dhe jo në fund. Duhet menduar që kur përgatitet outline i Rezultateve

11. Kur citon referencën, fokusi është tek ideja jo tek autori

30

- Arsyetja që citohet një referencë është ajo çka ajo përmban dhe jo autori që e ka shkruar; prandaj kjo duhet të jetë në fokusin e referencës; bëjnë përjashtim rastet kur mendimi i autorit, hipotezat janë të tilla që bëjnë të domosdoshëm zhvendosjen e vëmendjes tek autori

12. Shkrimi duhet të jetë i rrjedhshëm dhe tingëllues/ritmik

- Një shkrim mund të jetë shumë i mirë në formë dhe përmbajtje por jo detyrimisht i rrjedhshëm dhe ritmik. Ka të bëjë me mënyrën se si autori ndërton, rendit dhe shtjellon argumentat, çështjet dhe gjuhën që përdor.
- Kjo veti perceptohet menjëherë nga lexuesi dhe mund të ndikojë dhe në përmbajtje
- Ndhmon dhe vetë të kuptuarit të objektit por shton shumë pikët e cilësisë së ë shkruarit dhe tërheq në mënyrë të pakuptueshme lexuesin
- Lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me pasurinë vokale dhe me aftësitë e shkrimit artistik të autorit
- Aftësi që fitohet më shumë përmes përvojës, leximeve të shumta, perceptimit dhe nuhatjes se sa të mësuarit skolastik të rregullave përkatëse

13. Formatimi është po aq i rëndësishëm sa përmbajtja

- Formatimi me anë të kompjuterit lehtëson shkrimin dhe saktësinë gjuhësore të një botimi shkencor (sidomos në gjuhën angleze).
- Autori duhet të njohë mirë word processor dhe të familjarizohet me **standartet bazë të shkrimit dhe formatimit**: karakteret, paragrafet, organizmin e faqes, etj si dhe përpunimet bazë statistike për përgatitjen e figurave, tabelave, grafikëve, etj.
- **Çdo variant i përgatitur duhet të ruhet deri në përgatitjen e formës përfundimtare**
- Duhet bërë një **back-up kopje e çdo drafti të ri** si dhe kopje letër e çdo drafti deri në botimin e materialit.

14. Merr me seriozitet vërejtjet gjuhësore

33

- Kufizo fjalitë e gjata dhe me shumë presje.
- Përpara dërgimit tek botuesi, dërgoje draftin në një reçencë gjuhësore
- Reflekto çdo vërejtje gjuhësore dhe leksike
- Forma dhe rigoroziteti gjuhësor janë shumë të rëndësishme në impaktin e parë

15. Disa këshilla për stilin e të shkruarit

Çdo editorial ka kërkesat e veta specifike stilistike. Këto duhen ndjekur e zbatuar me përpikmëri pasi janë kriteret më lehtësisht të kapshme botuesi.

34

- Numri i faqeve, numri i karaktereve, Fonti dhe permasat vendosen rast pas rasti
- Numri i faqeve duhet të jetë sekuencial
- Çdo seksion duhet të nisë në faqe të re (sidomos për tezat apo review)
- Titujt e kapitujve apo pjesëve nuk duhen lënë në fund të faqes por kalohen në faqen vijuese
- Mënjano ndarjen e tabelave figurave në disa faqe
- Përdor të njëjtën kohë folje në çdo seksion
- Çdo mendim shprehet në paragrafë të veçantë. Bën përjashtim abstrakti
- Indent/tab rreshti i parë i çdo paragrafi
- Përdor kohën e tashme për fakte të pakundërshtueshme që nxirren si përfundim i punimit
- Përdor kohën e shkuar për rezultatet e veçanta të marra por që nuk dalin në një përfundim
- Mënjano gjuhën joformale, mos ju drejto direkt lexuesit, mos përdor fjalë zhargoniale, dialektore dhe mbiemra superlativë
- Mos e tepro me ilustrimet; mund të perceptohen si zëvendësues e varfëri e mendimit dhe aftësisë për shpjegimit

Prezantime të ardhshme

35

- 1. Standarte dhe udhëzime të veçanta për botimet në fushën e aktivitetit fizik dhe sportit**
- 2. Si shkruhet një tekst mësimor bazë**
- 3. Si shkruhet një tezë doktore**
- 4. Si shkruhet një paper review**
- 5. Si prezantohet një punim përpara një auditori**

Faleminderit!